



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER XHOANA OMARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR. 1
TEL: 0682055130

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 4035


Nr. koleksioni: 2099

Tirane më 11/09/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë



A2024053810244989041



A2024053810244989041

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SKIN AVENUE" SHPK

Sot, më datë _____, para meje Notere XHOANA OMARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR. 1, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Marsida Krasniqi, atësia Skënder, amësia Feridan, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan, me adresë Rruga Xhemal Myrhydari Nr 2; Elbasan; 0000; Elbasan, lindur më 25/10/1985, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036150923 dhe nr. personal I56025090G

THEMELUES

Elda Tomçini, atësia Sefedin, amësia Suzana, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr:Elbasanit; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 22/01/1971, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036035312 dhe nr. personal H15122123I

Neni 1- Emërtimi

- a. Shoqëria do të quhet Skin Avenue shpk. (këtu e më poshtë "Shoqëria").
- b. Shoqëria do të operojë gjithashtu me emrin tregtar "Zahra Beauty and Spa"

Neni 2- Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë do të jetë tek rr. Mihal Duri, Tiranë.
- 2.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 2.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 3- Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e papërcaktuar.



A2024053810244989041

Neni 4- Objekti i Shoqërisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Trajtime të bukurisë, Trajtime Flokësh, Thonjtë, masazhe dhe të tjera të ngjashme.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- a. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 lekë (dhjetëmijë lekë) i përbërë nga 2 kuota.
- b. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë nominale 5,000 lekë secila.
- c. Zj. Marsida Krasniqi zotëron 50 % të kapital të shoqërisë në vlerë 5,000 lekë (pesëmijë lekë).
- d. Zj. Elda Tomcini zotëron 50 % të kapital të shoqërisë në vlerë 5,000 lekë (pesëmijë lekë).
- e. Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuotat e pjesmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- Znj. Marsida Krasniqi, ofron një kontribut në para të barabartë me 5 000 leke (pese mije leke) lekë.
- Znj. Elda Tomcini, ofron një kontribut në para të barabartë me 5 000 leke (pese mije leke) lekë.

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Znj. Marsida Krasniqi i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 50% (njqind) të kapitalit të Shoqërisë
- Znj. Elda Tomcini i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 50% (njqind) të kapitalit të Shoqërisë

Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

7.2 Në rastin e transferimit të cdo lloj titulli, qoftë kundrejt një pagese apo jo në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra duke përfshirë dhurimin e aksioneve dhe personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, aksionet duhet të ofrohen me refuzimin e parë të Ortakëve të tjerë.

7.3 Në këtë rast ortaku shitës duhet tju komunikojë me shkrim ortakëve të tjerë, me anë të një letre rekomanduese a/r ku të shprehet qartë, vullneti për të shitur aksionet, kushtet e shitjes përfshirë emrin e blerësit, emrin e shitësit, cmimin e shitjes. E drejta e parablerjes duhet ti referohet gjithsesi të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

7.4 Anëtarët do të kenë 30 (tridhjetë) ditë kohë nga marrja e letrës a / r për të informuar aksionarin shitës për gatishmërinë e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Në rast të skadencës së afatit kohor, e drejta e parablerjes në favor të tyre do të bie poshtë.

7.5 Në rastin kur oferta pranohet nga shumica e Ortakëve, aksionet e shitura nga aksioneri ndahen në mënyrë proporcionale në bazë të aksioneve që zoterojnë secili prej tyre (pala



A2024053810244989041

- blerese), nese nuk bëhet një marrëveshje ndryshe ndërmjet palëve. Në asnjë rast ofruesi nuk
- do të pranojë një ushtrim pjesor të së drejtës së parablerjes.
- 7.6 Në rast të dështimit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, aksionet mund të transferohen drejt palëve të treta në tërësi ose në pjesë.
- 7.7 Njësitë mund të transferohen me anë të trashëgimisë në raste fatkeqësie.

Neni 8 – Administrimi

- Shoqëria administrohet nga dy administratorë, të cilet në të njëjtën kohë janë dhe ortakë në shoqëri. Administratorët e administrojnë bashkrisht shoqinë.
- Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve bëhet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e zakonshme.
- Administratorët emërohen me një mandat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- Në momentin e hartimit të këtij Akt Themelimi Administratorë të Shoqërisë “Skin Avenue” shpk janë Marsida Krasniqi dhe Elda Tomçini.

Neni 9 – Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 5 (pese) kopje në gjuhën shqipe.

THEMELUES

Marsida Krasniqi

Elda Tomçini

NOTER

XHOANA OMARI

